


V E N D I M
Nr. 3, datë 28.06.2021
PËR
**"PËR MIRATIMIN E PROGRAMEVE TË AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS
PËR PERIUdhËN QERSHOR-DHJETOR 2021 DHE MIRATIMIN E RREGULLORES
SË KËSHILLIT DREJTUES TË AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS"**

Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit Nr.115/017, "Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës" i ndryshuar, të Vendimit Nr. 114/2018 të Këshillit të Ministrave "Për emërimin, shkarkimin dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Agjencisë Kombëtare të Diasporës", si dhe në vijim të Vendimit nr. 02, datë 31.03.2021, të Këshillit Drejtues të Agjencisë Kombëtare të Diasporës" Për miratimin e planit dhe detajimin buxhetor 2021, Këshilli Drejtues

VENDOSI:

1. Miratimin e Rregullores së Këshillit Drejtues të Agjencisë Kombëtare të Diasporës, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Miratimin e programit të rishikuar të Agjencisë Kombëtare të Diasporës për periudhën Qershor-Dhjetor 2021, në vlerën 35,511,547 (tridhjetë e pesë milion e pesëqind e njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e dyzet e shtatë) lekë, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Me zbatimin e vendimit ngarkohet Agjencia Kombëtare e Diasporës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLI DREJTUES

Sokol	DEDJA	KRYETAR
Romina	KUKO	ANËTARE
Anila	FERIZAJ	ANËTARE
Ornela	ÇUÇI	ANËTARE
Ada	ILIA	ANËTARE
Suzana	STEFJA	ANËTARE
Kozeta	ANGJELIU	ANËTARE